

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.12.2022*

12.12.2022

Ora 16:30

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të kërkesave ankimore nr. 10, 11, 12, dhe nr. 13 “Kundërshtim i vendimit nr.224, dt.7.12.2022 të KSHZ”.

PJESËMARRJA:

- **Stafi KQZ: Y. Merkaj,**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 4 kërkesa ankimore. Kërkesa ankimore nr.10, 11, 12 dhe kërkesa ankimore nr. 13.

Për kërkesën ankimore nr. 10, ankuesi është Partia Demokristiane, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 224, dt. 7.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Kërkesa ankimore nr. 11, me ankues Partia Republikane, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 224, dt. 7.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Kërkesa ankimore nr. 12, me ankues OSHMA “Mat Tv”, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 224, dt. 7.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Kërkesa ankimore nr. 13, me ankues OSHMA “Club Tv”, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 224, dt. 7.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 14 të Rregullores së KAS-it, do të zhvillohet procedura e shortit për caktimin e relatorit, për ankimet e paraqitura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.12.2022*

përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për tërheqjen e goglave në emër dhe për llogari të tyre. Procedura e shortit është si më poshtë vijon:

Kemi përgatitur pesë shirita letre ku në katër kemi vendosur kërkesat ankimore dhe njëri shirit letre është i bardhë. Këta shirita futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë dhe më pas në një enë transparente. Duke filluar nga rendi alfabetik rritës nga emri i relatorit zotit Elvin Lako, zotit Elvis Cefa, zotit Ilirjan Rusmali, zotit Koli Bele dhe zotit Ledio Braho. Do të tërhiqen goglat në emër dhe për llogari të tyre. Vazhdojmë me procedurën, përzjehen goglat:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa – shiriti përmban kërkesa ankimore nr.11.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmalit - shiriti përmban kërkesa ankimore nr.13.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti përmban kërkesa ankimore nr.10.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho – shiriti përmban kërkesa ankimore nr. 12

Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit:

Kërkesa ankimore nr. 10, relator është zoti Koli Bele.

Kërkesa ankimore nr. 11, relator është zoti Elvis Çefa.

Kërkesa ankimore nr. 12, relator është zoti Ledio Braho.

Kërkesa ankimore nr. 13, relator është zoti Ilirjan Rusmali.

Me kaq përfundojmë procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e relatorëve për këto kërkesa ankimore, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

